



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 18 qershor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Urdhrit mbi
Zhvillimin e Gjykimit**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Lluka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21 dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 116(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 janar 2023, Trupi Gjykues miratoi udhëzime në lidhje me paraqitjen e provave dhe zhvillimin e gjykimit ("Urdhri") dhe urdhëroi palët dhe pjesëmarrësit t'i respektonin ato udhëzime.¹
2. Më 9 prill 2024, Mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (bashkërisht, "të akuzuarit" dhe "Mbrojtja") kërkuan bashkërisht ndryshimin e Urdhrit ("Kërkesa").²
3. Më 22 prill 2024, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës ("Përgjigjja").³
4. Më 29 prill 2024, Mbrojtja iu kundërpërgjigj Përgjigjes ("Kundërpërgjigjja").⁴
5. Më 1 dhe 7 maj 2024, Mbrojtja ngriti në sallë të gjyqit kundërshtime të ngjashme me ato në Kërkesë.⁵

¹ F01226, Trupi Gjykues, *Urdhër mbi Zhvillimin e Gjykimit* ("Vendimi lidhur me Urdhrin mbi Zhvillimin e Gjykimit"), 25 janar 2023, me një Shtojcë.

² F02230, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Masë Ndreqëse në Formë të Ndryshimit të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 9 prill 2024.

³ F02258, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshime në Urdhrin mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 22 prill 2024.

⁴ F02273, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes lidhur me Përgjigjen Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshime në Urdhrin mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 29 prill 2024.

⁵ Transkripti i seancës, 1 maj 2024, f. 15279, rreshtat 4-7; transkripti i seancës, 7 maj 2024, f. 15496, rreshti deri në f. 15497, rreshti 3.

II. PARASHTRIMET

6. Mbrojtja kërkon që në Urdhër të përfshihen tre ndryshime lidhur me përgatitjen e dëshmitarëve, përkatësisht: (i) ndalimi i mbledhjes së qëllimshme të provave të reja gjatë përgatitjes së dëshmitarëve; (ii) kushti i shprehur qartë që ZPS-ja të incizojë në audio dhe video të gjitha seancat përgatitore me dëshmitarë dhe, në veçanti, ato me të dyshuar të pretenduar; dhe (iii) kushti që ZPS-ja të dorëzojë shënimet nga seancat përgatitore me dëshmitarë (përkatësisht “seanca përgatitore” dhe “shënimet e seancës përgatitore”), më së paku 48 orë para fillimit të dëshmisë së planifikuar të dëshmitarit.⁶ Mbrojtja parashtron se këto ndryshime janë të domosdoshme, sepse ZPS-ja ka krijuar një praktikë të përdorimit të seancave përgatitore për të mbledhur prova të reja dhe për të vazhduar hetimet e veta.⁷

7. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të hidhet poshtë, sepse në të kërkohet rishikimi i Urdhrit pa i trajtuar kriteret e rregullës 79.⁸ ZPS-ja parashtron gjithashtu se Kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi tre ndryshimet e propozuara janë të pabaza, duke qenë se: (i) ato bazohen në pseudopasqyrime të seancave përgatitore të deritanishme; (ii) ZPS-ja i përmbahet Urdhrit; (iii) incizimet në audio dhe video janë të panevojshme; (iv) rregulla e re për dorëzimin e informacionit brenda 48 orëve nuk është as e nevojshme, as praktike; dhe (v) Mbrojtja nuk vë në dukje asnjë dëm konkret.⁹

8. Mbrojtja kundërpërgjigjet se rregulla 79 nuk është e vetmja mundësi për masën që kërkohet dhe se Kërkesën për masën ndreqëse e parashtroi, ndër të tjera, bazuar në nenin 40(6)(e)-(g).¹⁰ Mbrojtja shton se ZPS-ja nuk bën dallimin midis “vendimeve” dhe “urdhrave”, ku vetëm vendimet përfshihen shprehimisht në

⁶ Kërkesa, para. 1, 13, 19, 28, 33, 40, 42.

⁷ Kërkesa, para. 1, 12, 14-19, 24-27, 35.

⁸ Përgjigjja, para. 1, 3-4, 22.

⁹ Përgjigjja, para. 2, 22.

¹⁰ Kundërpërgjigjja, para. 2-4.

rregullën 79,¹¹ dhe se Mbrojtja e ka të pamundur të kërkojë rishikim të Urdhrit sepse nuk e ka në dispozicion arsyetimin.¹² Mbrojtja argumenton se, në qoftë se Trupi Gjykues gjykon se rishikimi është mundësia më e përshtatshme, kriteret për rishikim janë përmbushur meqë masa është e domosdoshme për të shmangur padrejtësinë dhe duke qenë se Mbrojtja ka vërtetuar ekzistencën e rrethanave të jashtëzakonshme.¹³

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Sipas nenit 40(2), Trupi Gjykues siguron që shqyrtimi gjyqësor të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procedurat të zhvillohen në pajtim me Rregulloren, në respekt të plotë të të drejtave të të akuzuarit dhe duke i kushtuar kujdesin e duhur mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve.

10. Sipas rregullës 116(1), Trupi Gjykues merr vazhdimisht të gjitha masat dhe miraton procedurat e nevojshme për lehtësimin e kryerjes së drejtë e të shpejtë të gjykimit.

11. Paragrafët 85 deri 99 të Urdhrit rregullojnë përgatitjen e dëshmitarëve për këtë proces. Paragrafët që lidhen më së shumti me vendimin aktual diskutohen hollësisht më poshtë.

IV. DISKUTIM

A. KËRKESA PËR RISHIKIM

12. Sa i takon argumentit të ZPS-së se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se janë përmbushur kriteret për një kërkesë për rishikim,¹⁴ Trupi Gjykues thekson si vijon.

¹¹ Kundërpërgjigjja, para. 5.

¹² Kundërpërgjigjja, para. 7.

¹³ Kundërpërgjigjja, para. 9.

¹⁴ Përgjigjja, para. 1, 3-4.

13. Së pari, Trupi Gjykses sqaron se rregulla 79 vlen për çdo vendim të lëshuar nga Trupi Gjykses, pavarësisht nëse quhet “urdhër” apo “vendim”. Nuk ka arsye që rregulla 79 të lexohet në kuptim të ngushtë që të vlejë vetëm për vendime të Trupit Gjykses që mbajnë titullin “vendim”.

14. Së dyti, Trupi Gjykses nuk bindet se Kërkesa në thelb është kërkesë për rishikim. Konkretisht, sipas rregullës 116(1), Trupi Gjykses “merr vazhdimisht të gjitha masat dhe miraton procedurat e nevojshme për lehtësimin e kryerjes së drejtë e të shpejtë të gjykimit”. Rrjedhimisht, kur miratoi Urdhri, Trupi Gjykses u shpreh se Urdhri “mbetet objekt i ndryshimeve të ardhshme nga Trupi Gjykses, nëse është e nevojshme, me ecurinë e gjykimit”.¹⁵ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se mund të ndryshojë (dhe ka ndryshuar tashmë)¹⁶ Urdhri kur është e nevojshme, pa zbatuar standardin e rishikimit sipas rregullës 79. Fakti që të njëjtat argumente, ose argumente të ngjashme janë parashtruar tashmë nga Mbrojtja e z. Krasniqi (“Mbrojtja e Krasniqit”) dhe shqyrtuar nga Trupi Gjykses, nuk ndikon në këtë mendim.¹⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit u bënë para fillimit të gjykimit, ndërsa masat aktuale kërkohen bazuar në aspekte dhe sfida që janë shfaqur gjatë procesit të gjykimit.¹⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e gjykon të paarsyeshme që Kërkesa t’i nënshtrohet standardit të përcaktuar në rregullën 79.

15. Në pajtim me rregullën 116(1) dhe faktin që Trupi Gjykses bëri me dije se Urdhri mund të ndryshohet, kur është e nevojshme, me ecurinë e gjykimit, Trupi

¹⁵ Vendimi lidhur me Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 10.

¹⁶ *Shih, për shembull*, F01960, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurores së Specializuar lidhur me Kontaktimin e Dëshmitarëve pas Dhënies së Dëshmisë*, 27 nëntor 2023, para. 15, 26; Transkripti i seancës, 13 prill 2023, f. 2813, rreshtat 17-21.

¹⁷ *Shih* F01207, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime të Mëtejshme të Mbrojtjes së Krasniqit krahas Parashtrimeve të Përbashkëta me Shkrim të Mbrojtjes në lidhje me Urdhri Paraparak mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 13 janar 2023, para. 17-23; F01246, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelimin e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 1 shkurt 2023, para. 22, 25-27.

¹⁸ Kërkesa, para. 1, 12, 14-15, 24, 26-27, 34-36, poshtëshënimet 11-13, 22-23, 27; Kundërpërgjigjja, para. 10-11, 15-16, 23.

Gjykues tani do të vlerësojë nëse ndryshimet e kërkuara janë të domosdoshme për të mundësuar kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.

B. KËRKESA PËR NDRYSHIMIN E URDHËRIT

16. Mbrojtja kërkon tre ndryshime në Urdhër.

1. Ndryshimi për ndalimin e mbledhjes së provave të reja

17. Mbrojtja kërkon që në Urdhër Trupi Gjykes të shtojë një paragraf, ku të përcaktojë se: “përgatitja e dëshmitarit nuk duhet të kryhet për mbledhjen e provave të reja ose vazhdimin e hetimeve të palës thirrëse.”¹⁹

18. Trupi Gjykes sqaroi në paragrafin 86 të Urdhrit qëllimin e përgatitjes së dëshmitarit:

86. Qëllimi i përgatitjes së dëshmitarit është:

i. Të ndihmojë dëshmitarin i cili do të japë dëshmi gjatë procesit gjyqësor:

(a) të sigurojë që dëshmitari jep dëshmi që lidhet me lëndën, të saktë dhe të strukturuar; dhe

(b) të sigurojë mirëqenien e dëshmitarit.

ii. Që pala thirrëse të vlerësojë dhe qartësojë dëshminë e dëshmitarit me qëllim mundësimin e marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë procesit në mënyrë të përqendruar, efikase dhe efektive.

19. Rrjedhimisht, është e qartë nga Urdhri se qëllimi i përgatitjes së dëshmitarit, ndër të tjera, është sigurimi i mirëqenies së dëshmitarit dhe mundësimi i marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë procesit në mënyrë të përqendruar, efikase dhe efektive. Megjithatë, Urdhri nuk ndalon palën thirrëse të marrë informacion të ri nga dëshmitari, e as nuk ndalon palën thirrëse t’i tregojë dëshmitarit dokumente, për të marrë informacion shtesë nga dëshmitari në lidhje me ato dokumente.

¹⁹ Kërkesa, para. 13(a), 14-23, në veçanti, para. 19; Kundërpërgjigjja, para. 10-14.

20. Gjithashtu, Trupi Gjykues nuk kufizoi përgatitjen e dëshmitarit në një proces ku pala thirrëse vetëm i jep dëshmitarit mundësinë të lexojë deklaratat e veta të mëparshme dhe të shpjegojë ndryshimet në to, nëse ka, sikurse argumenton Mbrojtja.²⁰

21. Konkretisht, sipas paragrafit 96 të Urdhrit, pala thirrëse duhet, ndër të tjera, të dorëzojë “informacion të ri të marrë nga dëshmitari”, që e bën të qartë se Trupi Gjykues parashikoi mundësinë që seancat përgatitore të rezultojnë në marrjen e informacionit të ri nga dëshmitari. Megjithatë, si garanci mbrojtëse, pala thirrëse duhet të evidentojë qartë informacionin e ri të marrë gjatë seancës përgatitore me dëshmitarin: (i) për t’i mundësuar palës kundërshtare përgatitje të efektshme; dhe (ii) për të siguruar se ky informacion nuk do të pranohet me shkrim sipas rregullës 154, por mund të paraqitet gojarisht gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit.

22. Në mbështetje të parashtrimeve të veta, Mbrojtja u referohet protokolleve për përgatitjen e dëshmitarëve në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (“GJPN”).²¹ Fillimisht, Trupi Gjykues thekson se ky juridiksion nuk u detyrohet praktikave të GJNP-së apo të tribunalëve të tjerë ndërkombëtarë (të ndërkombëtarizuar), megjithëse mund t’i gjykojë ato relevante për miratimin e praktikave të veta. Gjithashtu, Trupi Gjykues vë në dukje se praktikat e GJPN-së lidhur me këtë pikë kanë qenë të ndryshme, por se disa dhoma gjyqësore të GJPN-së kanë lejuar përgatitjen e dëshmitar dhe kanë miratuar protokolle për përgatitjen e dëshmitarëve.²² Në disa prej këtyre protokolleve është përcaktuar se “përgatitja e dëshmitarit nuk duhet të kryhet për të marrë prova të reja, apo për të vazhduar

²⁰ Kërkesa, para. 17, i referohet Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimin, para. 97.

²¹ Kërkesa, para. 18-19, 21-22.

²² Disa dhoma gjyqësore vendosën që të lejonin përgatitjen e dëshmitarëve, ndërsa disa dhoma gjyqësore të tjera vendosën të mos lejonin përgatitjen e dëshmitarëve; *Shih, për shembull*, ICC, *Prosecutor v. Al Hassan Ag Abdoul Aziz Ag Mohamed Ag Mahmoud*, ICC-01/12-01/18-666, Trial Chamber, [Decision on Witness Preparation and Familiarisation](#) (“Al Hassan Decision”), 17 March 2020, para. 10 (with further references), with one [Annex](#); *Prosecutor v. Bosco Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-652, Trial Chamber, [Decision on Witness Preparation](#) (“Ntaganda Decision”), 16 June 2015, para. 15 (with further references), with one [Annex](#).

hetimet e palës thirrëse”,²³ por pala thirrëse megjithatë lejohet shprehimisht “t’i tregojë dëshmitarit prova materiale të mundshme dhe t’i kërkojë dëshmitarit t’i komentojë ato, për të përcaktuar nëse ka dobi prej përdorimit të atyre provave materiale në gjyq,”²⁴ dhe, në disa protokolle, ta bëjë këtë “pavarësisht nëse dëshmitari i ka parë apo jo ato më parë”.²⁵ Një Dhomë e GJPN-së theksoi se kjo mundësi ka për qëllim të ndihmojë kryerjen efikase të procesit, të sigurojë që dëshmitari të jetë në gjendje të japë versionin më të plotë të dëshmisë së vet, dhe t’i japë dëshmitarit kohë të mjaftueshme për të gjykuar se çfarë informacioni relevant mund të japë lidhur me aspektin në fjalë, nëse ka.²⁶

23. Trupi Gjykues përsërit se seancat përgatitore kanë për qëllim të sigurojnë paraqitjen e provave në mënyrë të përqendruar, efikase dhe efektive.²⁷ Ato gjithashtu shërbejnë për të siguruar se pala thirrëse mund të diskutojë me dëshmitarin aspekte dhe dokumente që mund të jenë relevante për dëshminë e dëshmitarit.²⁸ Pala thirrëse ka njëfarë diskrecioni në lidhje me këtë dhe Trupi Gjykues nuk ndërhy, përveç nëse pala thirrëse keqpërdor diskrecionin ose kur informacioni i ri i marrë nga dëshmitari kërkon që Trupi Gjykues të miratojë ndonjë masë për të siguruar se palës kundërshtare nuk i shkaktohet dëm. Për të njëjtat arsye, Trupi Gjykues nuk bindet nga argumenti i Mbrojtjes se disa seanca përgatitore janë përdorur si mundësi për mbledhjen e provave të reja.²⁹

²³ *Shih, për shembull, [Annex to Al Hassan Decision](#), para. 2; [Al Hassan Decision](#), para. 25; [Annex to Ntaganda Decision](#), para. 2; ICC, *Prosecutor v. Francis Kirimi Muthaura and Uhuru Muigai Kenyatta*, ICC-01/09-02/11-588, Trial Chamber, [Decision on Witness Preparation](#) (“Kenyatta Decision”), 2 January 2013, para. 46, with one [Annex](#), para. 2.*

²⁴ *Shih, për shembull, [Annex to Ntaganda Decision](#), para. 24; [Kenyatta Decision](#), para. 37; [Annex to Kenyatta Decision](#), para. 23.*

²⁵ *Shih [Annex to Al Hassan Decision](#), para. 24.*

²⁶ *[Kenyatta Decision](#), para. 37; *Shih gjithashtu, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”), Prokurori kundër Fatmir Limajt dhe të tjerëve, IT-03-66-T, Trial Chamber, [Decision on Defence Motion on Prosecution Practice of “Proofing” Witnesses](#) (Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes në lidhje me Praktikën e Prokurorisë për “Përgatitjen” e Dëshmitarëve) (“Limaj Decision”) (Vendimi Limaj), 10 dhjetor 2004, f. 2.**

²⁷ *Urdhri, para. 86(ii).*

²⁸ *Shih, për shembull, [Limaj Decision](#), f. 2.*

²⁹ *Kërkesa, para. 15, poshtëshënimi 13.*

24. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se Rregullorja dhe Urdhri parashohin garanci të përshtatshme mbrojtëse. Konkretisht, pala thirrëse duhet të njoftojë palën kundërshtare për provat materiale të cilat synon të përdorë gjatë gjykimit duke dorëzuar listën e provave materiale të propozuara në përputhje me rregullën 95(4)(c) dhe rregullën 119(2)(b). Urdhri përcakton dispozitën shtesë sipas së cilës pala që paraqet provën duhet të njoftojë palën kundërshtare për dokumentet që synon të përdorë me dëshmitarin përkatës. Sipas paragrafit 82 të Urdhrit, pala paraqitëse dorëzon në kohë listën e provave materiale që synon të përdorë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të saj, dhe, “në qoftë se pala paraqitëse bëhet me dije për material shtesë që dëshiron të përdorë gjatë marrjes në pyetje të atij dëshmitari, pala paraqitëse: (i) njofton pa vonesë palën dhe pjesëmarrësit e tjerë dhe Trupin Gjykses; (ii) parashtron listën përfundimtare të materialit që do të përdoret dhe e kalon materialin shtesë në rendin e paraqitjes së provave jo më vonë se 24 orë para dëshmisë së dëshmitarit.” Krahas kësaj, “[k]ur materiali i ri është i rëndësishëm, pala kundërshtare mund të kërkojë shtyrje të seancës ose masa të tjera të nevojshme për t’i mundësuar asaj shqyrtim të mjaftueshëm të materialit dhe përgatitje të efektshme të marrjes në pyetje.”³⁰

25. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se kufizimi që kërkon Mbrojtja është i panevojshëm dhe i papërligjur në këto rrethana. Në qoftë se seanca përgatitore rezulton në marrjen e informacionit të ri të shumtë, Mbrojtja në atë moment mund t’i kërkojë Trupit Gjykses masë të përshtatshme, si për shembull shtyrjen e marrjes në pyetje të atij dëshmitari ose shtyrjen e shkurtër të seancës gjyqësore.

26. Për këto arsye, Trupi Gjykses hedh poshtë kërkesën e Mbrojtjes për t’i shtuar Urdhrit paragrafin e propozuar.

³⁰ Urdhri, para. 82; *Shih gjithashtu* Urdhrin, para. 74(vi).

2. Ndryshimi për të përfshirë kushtin e incizimit në audio dhe video të seancave përgatitore

27. Mbrojtja kërkon që Trupi Gjykses të ndryshojë Urdhrin për të përfshirë kushtin që ZPS-ja të incizojë në audio dhe video të gjitha seancat përgatitore me të gjithë dëshmitarët, dhe veçanërisht me të dyshuarit e pretenduar.³¹

28. Trupi Gjykses vëren shqetësimin e Mbrojtjes se “nuk ka mënyrë për të parë se si kryhet marrja në pyetje ose si merret informacioni i ri nga dëshmitarët, d.m.th. nëse është bërë në mënyrë sugjeruese dhe më pas incizuar sikur dëshmitari të ketë dhënë materialin pa marrë sugjerime.”³² Trupi Gjykses nënvizon se merret si e mirëqenë se pala thirrëse bën përmbledhjen e drejtë dhe të saktë të seancave përgatitore në shënimin e seancës përgatitore.³³ Krahas kësaj, sa i përket përdorimit të pyetjeve sugjeruese, Urdhri përcakton se avokati që merr në pyetje, ndër të tjera, nuk i bën dëshmitarit pyetje sugjeruese të papërshtatshme.³⁴ Bazuar në procesin e deritanishëm, Trupi Gjykses nuk sheh arsye për ta dyshuar deklaratën e ZPS-së se ajo angazhohet për “përgatitje legjitime të dëshmitarëve”.³⁵

29. Trupi Gjykses thekson se vendimi për incizimin në audio dhe video të seancave përgatitore është kompetencë diskrecionale e Trupit Gjykses përkatës, duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat relevante.³⁶ Trupi Gjykses nuk është

³¹ Kërkesa, para. 13(b), 24-33, në veçanti, para. 28, 33 ; Kundërpërgjigja, para. 15-21.

³² Kërkesa, para. 25.

³³ *Shih* Urdhrin, para. 88.

³⁴ *Shih* Urdhrin, para. 98(i).

³⁵ Përgjigja, para. 6-11.

³⁶ Për ilustrim të vendimeve që hodhën poshtë kërkesat për audio dhe videoincizime, *shih për shembull, Limaj Decision*; TPNJ, *Prokurori kundër Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84-T, Trial Chamber, *Decision on Defence Request for Audio-Recording of Prosecution Witness Proofing Sessions* (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Audioincizimin e Seancave Përgatitore të Dëshmitarëve të Prokurorisë), 23 maj 2007, para. 22; *Prokurori kundër Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84bis-T, *Decision on Lahi Brahimaj's Urgent Motion Seeking Memorialisation of Further Contact Between Prosecution and Witness 3*, (Vendim mbi Kërkesën Urgjente të Lahi Brahimajt për Pasqyrimin e Kontaktit të Mëtejshëm midis Prokurorisë dhe Dëshmitarit 3), 31 tetor 2011, para. 20. *Shih contra, Al Hassan Decision*, para., 43, 46; *Annex to Al Hassan Decision*, para. 12; *Annex to Ntaganda Decision*, para. 12; *Annex to Kenyatta Decision*, para. 12.

bindur se në këtë çështje është e nevojshme të urdhërojë palën thirrëse të incizojë në audio dhe video seancat përgatitore me dëshmitarët. Sipas paragrafit 88 të Urdhrit, pala thirrëse ka detyrimin të kryejë përgatitjen e dëshmitarit me ndershmëri dhe në përputhje me standardet e sjelljes dhe etikës profesionale në fuqi.³⁷

30. Gjithashtu, sipas paragrafëve 97 dhe 98 të Urdhrit, pala thirrëse u nënshtrohet detyrimeve dhe kufizimeve të qarta sa u përket aspekteve që duhet ose nuk duhet t'i diskutojë me dëshmitarin gjatë seancës përgatitore.

31. Për më tepër, pala thirrëse duhet të mbajë dhe dorëzojë evidencë të hollësishme të seancës përgatitore në përputhje me paragrafët 95 dhe 96 të Urdhrit.

32. Trupi Gjykses gjykon se këto janë garanci të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave të palës kundërshtare, e cila është e lirë t'i bëjë dëshmitarit pyetje lidhur me aspektet e përfshira në shënimet e seancës përgatitore, si edhe lidhur me kryerjen e seancës përgatitore. Trupi Gjykses nuk gjykon se Mbrojtja ka vërtetuar se incizimi në audio dhe video i seancave përgatitore është i domosdoshëm në këtë çështje gjyqësore për garantimin e drejtësisë së procesit.

33. Trupi Gjykses tani do të trajtojë argumentet e Mbrojtjes se pala thirrëse duhet të incizojë në audio dhe video seancat përgatitore me dëshmitarë të cilët konsiderohen të dyshuar nga ZPS-ja. Trupi Gjykses vëren argumentin e ZPS-së se Mbrojtja nuk ka të drejtë të bëjë parashtrime në emër të të dyshuarve.³⁸ Megjithëse Mbrojtja nuk ka të drejtë të përfaqësojë interesat e të dyshuarve të pretenduar, Mbrojtja ka të drejtë të ngrejë argumente që lidhen me respektimin e të drejtave të të akuzuarve dhe me drejtësinë e procesit. Trupi Gjykses është bindur se argumentet e Mbrojtjes lidhur me këtë pikë përfshihen në këtë kategori.

³⁷ *Shih gjithashtu, [Limaj Decision](#), f. 3.*

³⁸ Përgjigja, para. 15.

34. Mbrojtja mbështetet në rregullën 44 kur argumenton se ZPS-ja ka shkelur të drejtat e të dyshuarve me të cilët ka kryer seanca përgatitore.³⁹ Rregulla 44 në pjesën përkatëse përcakton:

(1) Gjatë marrjes në pyetje të një të dyshuari nga ana e Prokurorit të Specializuar, zbatohet procedura e përcaktuar në rregullën 43. Marrja në pyetje incizohet me video [...]

(2) Në rrethana të posaçme të cilat nuk mundësojnë videoincizimin e marrjes në pyetje të të dyshuarit, marrja në pyetje nga paragrafi (1) mund të kryhet edhe pa u videoincizuar. Prokurori i Specializuar dokumenton arsyet e mosndjekjes së procedurës së përshkruar në paragrafin (1).

(3) Në rast se në bazë të paragrafit (1) ose (2), marrja në pyetje nuk videoincizohet, Prokurori i Specializuar përgatit transkriptin me shkrim të marrjes në pyetje të të dyshuarit, dhe transkripti nënshkruhet prej Prokurorit të Specializuar dhe të dyshuarit. Prokurori i Specializuar dokumenton çdo refuzim të të dyshuarit për leximin ose nënshkrimin e transkriptit, si edhe arsyet e refuzimit, dhe u kërkon të gjithë të pranishmëve të tjerë ta lexojnë dhe nënshkruajnë transkriptin.

35. Rregulla 44 gjendet në Kapitullin 3 ("Hetimet"), Pjesën II të Rregullores, ku trajtohen "të drejtat e personave gjatë hetimit". Rrjedhimisht, kjo pjesë e Rregullores trajton hetimet dhe përcakton dispozita dhe garanci që vlejné konkretisht për atë fazë të procesit. Seancat përgatitore kryhen gjatë fazës së gjykimit të çështjes, që kryesisht trajtohet në Kapitullin 9 ("Procedura e Gjykimit") të Rregullores. Mbrojtja nuk ka paraqitur asnjë burim ligjor në mbështetje të sugjerimit se rregulla 44, përmes analogjisë, duhet të vlejë edhe për fazën e gjykimit të çështjes. Trupi Gjykues thekson se seanca përgatitore me një dëshmitar nuk është intervistë gjatë hetimit.⁴⁰ Trupi Gjykues thekson gjithashtu se shënimet e seancës përgatitore nuk nënshkruhen nga dëshmitari dhe se çdo aspekt që rrjedh nga seanca përgatitore, Mbrojtja mund ta diskutojë me dëshmitarin gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit. Gjithashtu, sikurse u theksua më lart, vendimi për të urdhëruar incizimin në audio dhe video të seancave përgatitore është

³⁹ Kërkesa, para. 31.

⁴⁰ ICC, *Prosecutor v. Al Hassan Ag Abdoul Aziz Ag Mohamed Ag Mahmoud*, Trial Chamber, ICC-01/12-01/18-734, [Decision on Defence Request for Reconsideration and, in the Alternative, Leave to Appeal the 'Decision on Witness Preparation and Familiarisation'](#), 9 April 2020, para. 25-26.

diskrecional, dhe jo vendim që rrjedh nga rregulla 44. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e gjykon të pathemeltë sugjerimin e Mbrojtjes se rregulla 44 përmes analogjisë vlen edhe për seancat përgatitore me dëshmitarët.

36. Trupi Gjykses rikujton gjithashtu se në Urdhër përfshiu disa garanci për dëshmitarë që janë njëkohësisht edhe të dyshuar. Në veçanti, Trupi Gjykses urdhëroi:

99. Kur personi është informuar për të drejtat dhe detyrimet sipas rregullës 43 si pjesë e hetimit dhe është intervistuar nga ZPS-ja përsëri përpara se të japë dëshmi, ZPS-ja e përsërit njoftimin kur vazhdon të ekzistojë dyshimi i arsyeshem se personi ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Kur një person është intervistuar gjatë hetimit pa iu dhënë ky njoftim, por në kohën e seancës përgatitore ZPS-ja ka arsye për të besuar se personi ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, ZPS-ja i jep personit njoftimin sipas rregullës 43.

37. Rrjedhimisht, gjatë seancave përgatitore me dëshmitarin, nëse ZPS-ja ka arsye për të besuar se dëshmitari ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, ajo duhet t'i japë dëshmitarit njoftim sipas rregullës 43. Rregulla 43, nga ana tjetër, kërkon që ZPS-ja të informojë dëshmitarin për të drejtat e përcaktuara në nenin 38(3) të Ligjit.

38. Krahas kësaj, sipas paragrafit 97(v) të Urdhrit, pala thirrëse duhet t'u bëjë me dije të gjithë dëshmitarëve se mund të këshillohen me avokat në rast se mendojnë se informacioni mund të jetë vetinkriminues. Sikurse u tha më lart, pala thirrëse duhet të mbajë dhe dorëzojë evidencën e hollësishme të seancës përgatitore në pajtim me paragrafët 95 dhe 96 të Urdhrit.

39. Trupi Gjykses gjykon se këto dispozita mbrojnë mjaftueshem interesat e dëshmitarëve të cilët janë të dyshuar dhe garantojnë mbrojtjen efektive të të drejtave të të akuzuarve.

40. Për të njëjtat arsye, Trupi Gjykses hedh poshtë gjithashtu sugjerimin e Mbrojtjes se ZPS-ja shkeli të drejtat e W04765-ës, W04323-shit dhe W04746-ës kur nuk incizoi seancat përgatitore të tyre.⁴¹

41. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses hedh poshtë kërkesën e Mbrojtjes për të përfshirë në Urdhrit një paragraf të ri për incizimin në audio dhe video të seancave përgatitore me dëshmitarët.

3. Ndryshimi për të ndryshuar afatin për dorëzimin e shënimeve të seancës përgatitore

42. Mbrojtja kërkon që Trupi Gjykses të ndryshojë paragrafin 96 të Urdhrit ku të përfshijë detyrimin sipas të cilit “pala thirrëse u dorëzon palës jothirrëse dhe pjesëmarrësve dhe Trupit Gjykses të gjithë informacionin që është objekt i detyrimeve të palës për nxjerrje të materialit”, më së paku 48 orë para fillimit të dëshmisë së dëshmitarit, në vend të më së paku 24 orë para fillimit të dëshmisë së dëshmitarit, sikurse përcaktohet aktualisht.⁴²

43. Trupi Gjykses rikujton se në pjesën përkatëse të paragrafit 96 të Urdhrit përcaktohet:

96. Së paku 24 orë para fillimit të dëshmisë, pala thirrëse u dorëzon palës jothirrëse dhe pjesëmarrësve dhe Trupit Gjykses të gjithë informacionin që është objekt i detyrimeve të palës për nxjerrje të materialit, përfshirë: (i) sqarime, ndryshime ose korrigjime të dëshmitarit në deklaratat e veta të mëparshme dhe arsyet, nëse ka, të dëshmitarit që përlligjin ndryshimin ose korrigjimin; dhe (ii) informacion të ri të marrë nga dëshmitari [...].

44. Gjithashtu, sipas paragrafit 94 të Urdhrit, pala thirrëse “përpiqet të kryejë seancat përgatitore *sa më shpejt që të jetë e mundur* dhe gjithsesi më së paku 24 orë para fillimit të dëshmisë së dëshmitarit”. Rrjedhimisht, nga Urdhri del qartë se, megjithëse seanca përgatitore duhet të kryhet më së paku 24 orë para fillimit të

⁴¹ Kërkesa, para. 31.

⁴² Kërkesa, para. 13(c), 34-40, në veçanti, para. 40; Kundërpërgjigja, para. 1, 22-24.

dëshmisë së dëshmitarit, pala thirrëse pritet ta kryejë atë më shpejtë, nëse është e mundur, për të siguruar dorëzimin në kohë të shënimeve të seancës përgatitore.

45. Trupi Gjykes pranon shqetësimet që ngre Mbrojtja se sipas interpretimit të ZPS-së afati prej 24 orësh përfshin fundjavat dhe orët jashtë orarit të punës,⁴³ dhe e pranon se dorëzimi i shënimeve të seancës përgatitore të premtën në mbrëmje ose gjatë fundjavës për një dëshmitar që fillon me dhënien e dëshmisë të hënën paradite, mund të dëmtojë mundësinë e saj për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes.

46. Trupi Gjykes vëren gjithashtu se ZPS-ja ka bërë me dije se, në lidhje me disa dëshmitarë të caktuar, mund të jetë në gjendje t'u përgjigjet kërkesave për dorëzimin e shënimeve të seancës përgatitore para afatit të përcaktuar në Urdhër, në qoftë se kërkesat bëhen mjaftueshëm në kohë para fillimit të dëshmisë së planifikuar.⁴⁴ Trupi Gjykes u kërkon të dyja palëve të kryejnë diskutime *inter partes* për t'i evidentuar këta dëshmitarë.

47. Trupi Gjykes gjykon se ZPS-ja duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar dorëzimin e shënimeve të seancave përgatitore sa më shpejtë që të jetë e mundur pas përfundimit të tyre. Trupi Gjykes gjykon gjithashtu se, sa u takon dëshmitarëve me dëshmi të kompleksitetit më të lartë, ZPS-ja duhet të sigurojë që seancat përgatitore me këta dëshmitarë të kryhen mjaftueshëm në kohë para fillimit të dhënies së dëshmisë, për të siguruar dorëzimin e shënimeve të seancave përgatitore të tyre në një mënyrë që është në përputhje me të drejtat e të akuzuarve për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së vet. Për këtë qëllim, seancat përgatitore me këta dëshmitarë ZPS-ja pritet t'i organizojë mjaftueshëm në kohë para fillimit të dëshmimeve të tyre, për të garantuar dorëzimin në kohë të shënimeve të seancave përgatitore të tyre.

⁴³ Kërkesa, para. 35-36.

⁴⁴ Përgjigja, para. 18.

48. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se ZPS-ja është e gatshme t'u përgjigjet shqetësimeve të Mbrojtjes lidhur me këta dëshmitarë, Trupi Gjykses aktualisht nuk e sheh të nevojshme që të ndryshojë zyrtarisht Urdhrin.

49. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses hedh poshtë kërkesën e Mbrojtjes për ndryshimin e afatit për dorëzimin e shënimeve të seancave përgatitore, të përcaktuar në paragrafin 96 të Urdhrit.

V. VENDIM

50. Për këto arsye, Trupi Gjykses **HEDH POSHTË** Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 18 qershor 2024

Hagë, Holandë.